

## **RELACION**

### **PËR**

### **PROJEKTLIGJIN**

## **PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9918, DATË 19.5.2008 “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “*Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, propozohet në kuadër të nismës legislative që Këshilli i Ministrave ushtron në mbështetje të nenit 81/1 të Kushtetutës. Propozimi paraparak në KM i projektaktit është nismë e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, në përputhje me fushat e veprimtarisë që mbulohen nga këto institucione.

Qëllimi i propozimit të këtyre ndryshimeve konsiston në përmirësimin e rregullimeve ekzistuese lidhur me çështjet e mëposhtme:

- mundësimi i rregullimit të tarifave për shërbimet e roamingut;
- përmirësimi i shërbimeve për thirrjet drejt numrave të emergjencave sipas direktivës 2002/22/EC;
- rritja e kapaciteteve të Prokurorisë dhe autoritetet/institucionet e zbatimit të ligjit për luftën kundër kriminalitetit duke plotësuar rekomandimet e BE-së për sigurimin në kohë reale të të dhënave nga kompanitë telefonike, si dhe,
- transpozim më i mirë i direktivës 2002/20/EC të BE-së, lidhur me mekanizmin e balancimit të të ardhurave të siguruara nga pagesat e tregut me kostot administrative të AKEP-it.

### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj ka karakter teknik dhe lidhet me programin analitik të Këshillit të Ministrave, me prioritetet e qeverisë për luftën kundër krimit të

organizuar dhe korrupsionit, si dhe për aspiratat e Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Europian. Gjithashtu projektligji synon të përmbushë angazhimet e MSA-së në zbatim të nenit 104 të saj për rrjetet e komunikimeve elektronike.

Nevoja e hartimit të këtij projektligji në lidhje me forcimin e kapaciteteve për luftën kundër kriminalitetit është parashtruar prej kohësh nga strukturat e Policisë së Shtetit për të zgjidhur përfundimisht kontradiktën mes tij dhe Ligjit për Policinë e Shtetit<sup>1</sup>. Për më tepër, detyrimi për hartimin e këtij projektligji parashikohet në dokumentet dhe rekomandimet që lidhen me integrimin evropian, më konkretisht:

- Në Udhërrëfyesin për plotësimin e Prioritetit 3 “Lufta Kundër Korrupsionit” në masën 3.6.3 është parashikuar: “*Rishikimi i ligjit për komunikimet elektronike*”;
- Në dokumentin “Non Paper” dërguar nga Komisioni Evropian në Shkurt 2015, ku adresohen disa masa ligjore që duhen ndërmarrë në një afat të shkurtër është dhe rekomandimi për ndryshimin e nenit 101 të ligjit për Komunikimet Elektronike. Në seksionin IV, Komunikimi elektronik thuhet:

### ***Neni 101 i "ligji nr.9918/2008 për Komunikimin Elektronik"***

#### ***Analiza dhe Rekomandime***

*Ofruesit e internetit dhe të shërbimit telefon e vonojnë dhënien e informacionit të kërkuar nga organet e zbatimit të ligjit. Aktualisht, i duhet edhe tridhjetë ditë për të marrë informacionin. Kjo praktikë mund të rrezikoj çdo hetim. Prandaj rekomandohet për ti paraqitet detyrimi ofruesve të internetit dhe të telefonit që t’ju sigurojnë menjëherë organeve të zbatimit të ligjit të dhënat e kërkuara. Duhet të paraqitet një sanksion parandalues në rast vonese. Është i nevojshëm interpretimi i saktë i nenit 101 të Ligjit për Komunikimet Elektronike për ti bërë të mundur të policisë gjyqësore që të bëjë drejtpërdrejt një kërkesë dhe mbledh të dhënat e mëposhtme: i) Identiteti i personit (abonentit) i cili zotëron një numër të telefonit apo IMEI apo një lidhje të internetit (IP) tashmë të njohur; ii) numrin e telefonit ose lidhjen e internetit (IP) i regjistruar në emër të një personi të caktuar”.*

- Në Progres Raportin 2015 për Shqipërinë, Komisioni Evropian rekomandon:

---

<sup>1</sup> Neni 129 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” nuk ka gjetur zbatim për shkak se pretendohet se bie ndesh me Ligjin për komunikimet elektronike.

“Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për të siguruar akses të drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave për prokurorët dhe policinë; zgjerimin e sistemit të menaxhimit në zyrat e prokurorisë dhe të sigurojë përdorimin efikas të tyre”.<sup>2</sup>

“Bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë dhe policisë ka nevojë të përmirësohet në mënyrë që hetimet paraprake të bëra nga tre-institucionet, të kryhen si rezultat i mbledhjes inteligjente proaktive si dhe aksesit në informacion si në databazat publike dhe ato private”.<sup>3</sup>

Në muajin Dhjetor 2015, gjatë një procesi të udhëhequr nga Ministria e Integritimit Evropian, është përfunduar plani i masave për zbatimin e rekomandimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Progres Raportit 2015 të Komisionit Evropian për luftën kundër korrupsionit (*prioriteti 3*) dhe krimin të organizuar (*prioriteti 4*). Një ndër masat e planit për plotësimin e rekomandimeve afatgjata të Progres Raportit 2015 është edhe hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për disa shtesa në ligjin 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike, i ndryshuar”.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është parashikuar edhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2016-2020, në masat afatmesme të Kapitullit 24.

Ndryshimet e tjera të paraqitura në projektligj, si ato për shërbimet drejt numrave të emergjencës, për mundësimin e rregullimit të tarifave të roamingut si dhe mekanizmat e balancimit të duhur midis të ardhurave dhe shpenzimeve të AKEPit, vijnë si kërkesë për përmirësim të rregullimeve ekzistuese ligjore dhe janë evidentuar në praktikë nga institucionet zbatuese.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në momentin aktual që po kalon vendi në proceset integruese, kryefjala është lufta kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit veçanërisht në nivelet e larta dhe në gjyqësor. Miratimi i Projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9918,

---

<sup>2</sup> Albania 2015 Report, pg.15, (Progres Raporti 2015, për Shqipërinë, Komunikim i Komisionit Evropian) fq.15.

<sup>3</sup> Po aty fq.56

datë 19.5.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka për qëllim rritjen e kapaciteteve pikërisht në këtë drejtim. Pritshmëritë janë që të rritet ndjeshëm parandalimi i krimit si dhe zbulimi dhe hetimi i rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Gjithashtu, projektligji vjen si nevojë për përmirësim të rregullimeve për shërbimet e roamingut dhe për numrat e emergjencës duke synuar një mbrojtje të konsumatorit nga tarifat e larta roaming si dhe një shërbim më efikas në rastin e thirrjeve të emergjencave.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji që propozohet mbështetet në nenet 78, 81 dhe 83 të Kushtetutës dhe është në harmoni me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky projektakt do të ketë vendin e vet në hierarkinë e normave ligjore të parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektligji synon përafrim të pjesshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian përkatësisht me pikën 2, të nenit 12 të direktivës 2002/20/EC dhe të pikës 5 të nenit 26, të direktivës 2002/22/EC.

#### **VI. PËRMbledhje SHpjeguese E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet nga gjashtë nene.

Në **nenin 1** propozohet një shtesë në pikën 2 të nenit 55, “Rregullimi i tarifave”. Sipas rregullimit ekzistues, AKEP-i ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave nëpërmjet një vendimi për rregullimin e tarifave, për shërbimet e përfshira në skemën e shërbimit universal, dhe shërbimet e ofruara nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg në tregun përkatës. Shtesa e propozuar mundëson që AKEP-i të rregullojë dhe shërbimet e roamingut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara për zbatim me interes reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime. Formulimi mban parasysh specifikat që ka ofrimi i

shërbimit të roamingut, ku aplikimi i rregullimit me interes për konsumatorin shqiptar kërkon rregullimin me zbatim reciprok me vendet e tjera.

Në **nenin 2** propozohet një ndryshim dhe një shtesë në neni 89, “Numeracioni për shërbimet e thirrjeve të emergjencës”. Ndryshimi i pikës 2, lidhet me plotësimin e bërë në pikën e shtuar 3. Pika 2, qartëson detyrimin e zotësuesve të sipërmarrësve për të ofruar pa pagesë thirrjet drejt numrave të emergjencës dhe për qartësim është ndarë me vetë pika 3.

Në pikën 3, kërkohet që: *“Sipërmarrësi i ofron pa pagesë, autoritetit përgjegjës për pritjen dhe administrimin e thirrjeve të emergjencës, përfshirë dhe ato drejt numrit 112, informacion për numrin thirrës dhe vendndodhjen e tij, sapo kryhet një thirrje drejt numrit të emergjencave.”*

Ky plotësim, i kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë, mbështetet në parashikimin e paragrafit 5, të nenit 26 të direktivës 2002/22/EC, për shërbimin universal në komunikimet elektronike dhe synon përmirësimin e shërbimeve për thirrjet drejt numrave të emergjencave për një veprim në kohë sa më shpejt në rast kërkese të ndihmës për të gjitha llojet e emergjencave duke pasur parasysh që numri 112, është numri unik i emergjencave i harmonizuar në nivel evropian. Aktualisht ligji e parashikon dhënien e informacionit të vendndodhjes për numrat e emergjencës për aq sa është e mundur teknikisht. Kërkesa e re bën këtë detyruese për operatorët, gjë që do dojë dhe përshtatje teknike nga ana e tyre. Shtesa e pikës 3, të nenit 89, është shoqëruar dhe me dispozitë kalimtare për zbatim në nenin 5.

Në **nenin 3**, të projektligjit bëhen disa ndryshime në nenin 101. Titulli i nenit propozohet të behet *“Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale, ruajtjes së sigurisë publike dhe kombëtare”*. Ky ndryshim shton frazën: *“ruajtjes së sigurisë publike dhe kombëtare”* dhe ka si qëllim përputhjen më të mirë të titullit me përmbajtjen e kësaj dispozite.

Sillet një riformulim i pikës 6, të nenit 101, ku parashikohet vendosja e një afati prej 7 ditësh për dhënien e informacionit nga kompanitë që ofrojnë komunikime elektronike në kuadër të një hetimi penal për Gjykatën, Prokurorinë dhe Policinë Gjyqësore për të dhënat e skedarëve. E reja në riformulium qëndron në vendosjen e afatit që aktualisht është “pa vonesë”, por ky përcaktim evaziv në

ligj ka sjellë problematikë në zbatimin praktik me vonesa të pajustificuara si dhe qartëson autoritetet që referohen në Kodin e Procedures Penale si më sipër.

Në nenin 101 janë parashikuar të shtohen pikat 7, 8, 9, dhe 10. Në pikën 7 është bërë parashikimi që afati për tri të dhëna operative që kanë të bëjnë me identifikimin e pajtimtarit, kur dihet numri apo adresa e IP, identifikimin e pajisjeve apo adresave të IP për një pajtimtar të dhënë, dhe identifikimin e vendndodhjes së një pajisje fundore apo IP, kërkesa e autoriteteve të përcaktuara në pikën 6, të plotësohet brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës.

Në pikën 8, parashikohet që të dhënat operative të identifikimit të pajisjes, pajtimtarit dhe vendndodhjes, të përcaktuara në pikën 7, për nevoja të ruajtjes së sigurisë publike dhe kombëtare, parandalimit të krimeve të rënda dhe akteve terroriste, t'ju vihen në dispozicion mbi bazën e kërkesës brenda 24 orëve, dhe shërbimeve Informative dhe të Inteligjencës, Policisë së Shtetit dhe Policisë Ushtarake. Shtimi i kësaj pike lidhet me rekomandimet për ndryshim të nenit 101, të ligjit për komunikimet elektronike dhe kërkohet nga partnerët ndërkombëtarë për dhënien e aksesit për Policinë e Shtetit dhe Shërbimeve të Inteligjencës për veprimtarinë e tyre informative-gjurmuese për parandalimin e krimeve dhe ruajtjen e sigurisë publike dhe kombëtare, siç mund të jenë situatat emergjente për parandalimin e akteve të rënda kriminale, akteve terroriste, etj. Në këtë pike përcaktohet qëllimi i dhënies së informacionit, institucionet që kanë të drejtë për marrjen e këtij informacioni dhe afati.

Me pikat 9 dhe 10, përcaktohet mënyra e dhënies së informacionit dhe trajtimi i tij në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar. Gjithashtu për të standartizuar formën e kërkesës dhe procedurën e përdorur në këtë rast është parashikuar që mënyrat konkrete të kërkimit dhe dhënies së informacionit do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në **Nenin 4**, parashikohet një ndryshim në nenin 117 “Financimi dhe buxheti i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” të ligjit. Reformulimi i pikës 4, dhe shtimi i pikës 5 në nenin 117, kanë si qëllim prezantimin e një mekanizmi balancimi midis të ardhurave dhe shpenzimeve të AKEP gjatë një viti.

Kërkesa për zhvillimin e këtij mekanizmi buron nga pika 2 e nenit 12 të direktivës 2002/20/EC të BE-së, sipas të cilës pagesat që kryhen prane organit

rregullator synojnë vetëm mbulimin e kostove administrative për funksionimin e tij. Gjithashtu ky propozim vjen në plotësim të parashikimit në pikën 3/a, të nenit 119 të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Pagesat që ju imponohen sipërmarrësve duhet të jenë transparente, objektive dhe proporcionale. Në rastin, kur kemi diferenca midis të ardhurave të krijuara dhe kostove administrative kërkohet të ketë një mekanizim për rregullimin e duhur që të shmangen pagesa shtesë nga sipërmarrësit përtej nevojës për mbulimin e kostove administrative të AKEP.

Theksojmë se ky ndryshim nuk cënon të ardhurat e buxhetit të shtetit që vijnë nga përdorimi i frekuencave si ato nga dhënia e autorizimeve me konkurim ashtu dhe ato nga pagesat vjetore të cilat derdhen në buxhetin e shtetit.

Ndryshimi i propozuar do bëjë të mundur që të zbatohet më mirë parimi i proporcionalitetit i kërkuar nga direktiva dhe neni 119 i ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Gjithashtu ai mbështetet në praktika të ngjashme të zbatuara për organet rregullatore që veprojnë në vend si për AMA ku parashikimi në pikën 5, të nenit 25, të ligjit nr. 97/2013 Për median audiovizive, përcakton se “Çdo tepricë nga të ardhurat nga pagesat, që mbetet nga shpenzimet përkatëse funksionale të AMA-s, në përfundim të vitit financiar, mbahet në llogaritë e AMA-s, përfshihet në planin e shpenzimeve të vitit pasardhës dhe mbahet parasysht në rishikimin e pagesave përkatëse vjetore për licencë.”

Në **nenin 5**, është parashikuar një periudhë tre mujore për plotësimin me aktin nënligjor që lidhet me ndryshimin e nenit 101, si dhe një periudhë kalimtare prej 6 muajsh për përmbushjen e kërkesës së re për dhënien në kohë reale të vendndodhjes së thirrjes drejt numrit të emergjencës. Periudha tranzitore mban parasysht që operatorët do duhet të përshtasin sistemet e tyre me këtë kërkesë të shtuar.

Në **nenin 6**, parashikohet hyrja në fuqi e ligjit që është 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve publike, AKEP-i, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratës Publike dhe subjektet e tjera të përcaktuara në ligj.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Drafti i parë i projektligjit është hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit, asistuar dhe dakordësuar me partneret ndërkombëtarë si PAMECA dhe ICITAP.

Si rezultat i nevojës për rishikim dhe plotësime me ndryshimet e paraqitura në nenet 1, 2 dhe 4 të projektligjit, të evidentuara nga disa institucione, projektligji i paraqitur për mendim është ripunuar nga një grup ndërinstytucional pune me përfaqësues të Ministrit të Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Ministrise se Drejtësisë, Ministrisë së Integritit Evropian; Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe AKEP-it.

Nga pikëpamja procedurale, referuar fushës së veprimtarisë shtetërore që mbulon komunikimet elektronike dhe çështjeve thelbësore që propozohen për ndryshim, projektligji propozohet në KM nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratës Publike dhe Ministri i Punëve të Brendshme.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.

**MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN  
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE**

**MILENA HARITO**

**MINISTËR I PUNËVE TË  
BRENDSHME**

**SAIMIR TAHIRI**